



Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim

Resource Center for Learning and Consulting

Lef Nosi

Rr. Zahir Pajaziti p.n. 20000 Prizren, Kosovë • Tel.: +383 (29) 241 037

Njësia mësimore: Unë nevojat dhe dëshirat

Rrezultatet e pritura:

- të kuptojë se çka është nevojë dhe çka është dëshirë
- të shpjegojë se cilat janë nevojat dhe dëshirat e veta
- të dallon nevojën nga dëshira

Materiali i nevojshëm:


- Libri
- fotografi të ndryshme
- fleta e bardhë
- lapsi
- ngjyra druri

Përshkrimi i aktiviteteve:

Ne kemi nevoja dhe dëshira. Nevojat janë shumë të domosdoshme për jetën tonë, sepse pa to ne nuk mund të jetojmë, sic janë për shembull ushqimi, uji, veshëmbathja etj. Dëshirat janë gjëra të cilat ne ëndërrojmë apo duam t'i kemi, sic është për shembull, të shëtisim botën, të kemi një lodër të caktuar, të vizitojmë të afërmit etj.

Aktiviteti 1:

Shkruani cilat janë nevojat dhe cilat dëshirat në bazë të figurave të mëposhtme:



NEVOJAT:

DËSHIRAT:

Aktiviteti 2:

Shkruani dhe vizatoni dëshirat tuaja.

Nevojat tuaja:	Dëshirat tuaja:
----------------	-----------------